



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit TM4 2019



Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka filluar të publikoj Indeksin e çmimeve të prodhimit (IÇP) nga muaji Maj 2009.

Çmimet dhe vlera e prodhimeve industriale janë grumbulluar nga ndërmarrjet prodhuese më ndikim në Kosovë. Vlera e prodhimit dhe çmimi mesatar vjetor i referohen vitit 2007, ndërsa nga tremujori i parë i vitit 2009, është duke u bërë monitorimi dhe llogaritja e indeksit në vazhdimësi, në periudha tremujore dhe vjetore.

IÇP - Indeksi i çmimeve të prodhimit është në përputhshmëri me Klasifikimin Standard të Veprimtarive sipas NACE rev.2, bazuar në "Reregulloren Nr.11/2013 neni 7 për implementimin e standartit për klasifikimin e veprimtarive" IÇP është në zhvillim e sipër dhe synon të përfshijë në vazhdimësi aktivitete ekonomike të cilat për momentin nuk janë aktive, por, gradualisht pritet prodhimi nga këto aktivitete.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato të dërgohen në adresën elektronike: economic@ks-gov.net.

Ky publikim është përgatitur nga:

Ilir T. Berisha - Drejtori i Departamentit

Ibish Asllani - Shef divizionit

Hamdi Jupolli - Shef Sektori

Hasan Berisha-Zyrtar i lartë

Mars 2020

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,
Isa Krasniqi

Simbolet dhe Shkurtesat

| | | |
|-----|---|---------------------------------------|
| IÇP | - | Indeksi i Çmimeve të Prodhimit |
| ASK | - | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| NVE | - | Nomenklatura e veprimtarive ekonomike |
| TM1 | - | Tremujori i parë |
| TM2 | - | Tremujori i dytë |
| TM3 | - | Tremujori i tretë |
| TM4 | - | Tremujori i katërt |

| | | |
|---|---|--|
| : | - | Shfra nuk është disponibël |
| 0 | - | Më pak se gjysma e njësisë së përdorur |
| - | - | Nuk aplikohet |
| % | - | Përqindje |
| W | - | Ponderët statistikor (pesha specifike) |
| ∅ | - | Mesatare |

Përmbajtja

| | Faqe |
|---|------|
| Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) për tremujorin e katërt - 2019 | 4 |
| Tabela 1: Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) TM1 2009 – TM4 2019 (2010=100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje | 5 |
| Tabela 2: Peshat, indeksi i çmimeve të prodhimit (2010=100) dhe ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje | 7 |
| Metodologjia | 8 |

Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) për tremujorin e katërt - 2019

Indeksi i tërsishëm i çmimeve të prodhimit në Kosovë pësoj rënie për -0.6% mes të TM3 2019 dhe TM4 2019. Krahasuar me TM4 2018 çmimet e prodhimit u ulen në një mesatare prej -0.1%.

Tremujori i tretë 2019 – Tremujori i katërt 2019 -0.6%

Çmimet e prodhimit në Kosovë pësuan rënie në një mesatare prej -0.6%, të TM3 2019 dhe TM4 2019. Rënie më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vrehen te: nxjerrja e xehes së metalit (-5.9%), prodhimi i metaleve (-1.4%), energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajr të kondicionuar (-0.8%), prodhimi i produkteve minerale jo metalike (-0.7%), prodhimi i produkteve kimike (-0.7%), prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (-0.6%), prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (-0.6%), përpunimi i produkteve ushqimore (-0.5%) dhe prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës (-0.1%).

Rënia u neutralizua me ngritjen e çmimeve te: prodhimi i mjeteve motorike të (transportit), rimorkiove dhe gjysem rimorkiove (8.1%), prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gëshetuara – thurëse (2.2%), prodhimi i pajisjeve elektrike (1.0%), prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (1.0%) dhe prodhimi i mobilieve (0.2%).

Tremujori i katërt 2018 - Tremujori i katërt 2019 -0.1%

Çmimet e Prodhimit në Kosovë pësuan rënie në një mesatare prej -0.1 % në mes të TM4 2018 dhe TM4 2019. Rënie më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: nxjerrja e xehes së metalit (-19.6%), prodhimi i produkteve kimike (-3.1%), prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës (-2.1%), energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajr të kondicionuar (-1.5%), grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë (-1.2%), prodhimi i pijeve (-0.1%) dhe prodhimi i metaleve (-0.1%).

Rënia u neutralizua nga ngritja e çmimeve te: prodhimi i mobilieve (3.9%), prodhimi i mjeteve motorike të (transportit), rimorkiove dhe gjysem rimorkiove (3.5%), prodhimi i produkteve minerale jo metalike (2.7%), prodhimi i pajisjeve elektrike (1.3%), prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gëshetuara – thurëse (1.1%), përpunimi i produkteve ushqimore (0.8%), prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (0.8%), prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (0.6%) dhe prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (0.2%).

Tabela 1: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) TM1 2009 – TM4 2019 (2010=100), Ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje

| Viti | Tremujori | Index (2010=100) | Ndryshimi tremujor në (%) | Ndryshimi vjetor në (%) |
|------|-------------------------------|------------------|---------------------------|-------------------------|
| 2009 | TM1 | 94,9 | : | : |
| | TM2 | 96,5 | 1,7 | : |
| | TM3 | 96,5 | 0,0 | : |
| | TM4 | 96,6 | 0,1 | : |
| | Mesatarja vjetore 2009 | 96,1 | : | : |
| 2010 | TM1 | 97,1 | 0,5 | 2,3 |
| | TM2 | 98,0 | 0,9 | 1,6 |
| | TM3 | 101,1 | 3,2 | 4,8 |
| | TM4 | 103,9 | 2,8 | 7,6 |
| | Mesatarja vjetore 2010 | 100,0 | : | 4,1 |
| 2011 | TM1 | 105,2 | 1,3 | 8,3 |
| | TM2 | 104,5 | -0,7 | 6,6 |
| | TM3 | 104,4 | -0,1 | 3,3 |
| | TM4 | 104,2 | -0,2 | 0,3 |
| | Mesatarja vjetore 2011 | 104,6 | : | 4,5 |
| 2012 | TM1 | 104,6 | 0,4 | -0,6 |
| | TM2 | 105,8 | 1,1 | 1,2 |
| | TM3 | 107,1 | 1,2 | 2,6 |
| | TM4 | 108,8 | 1,6 | 4,4 |
| | Mesatarja vjetore 2012 | 106,6 | : | 1,9 |
| 2013 | TM1 | 111,3 | 2,3 | 6,4 |
| | TM2 | 109,3 | -1,8 | 3,3 |
| | TM3 | 106,9 | -2,2 | -0,2 |
| | TM4 | 109,0 | 2,0 | 0,2 |
| | Mesatarja vjetore 2013 | 109,1 | : | 2,4 |
| 2014 | TM1 | 109,8 | 0,7 | -1,3 |
| | TM2 | 109,5 | -0,3 | 0,2 |
| | TM3 | 110,8 | 1,2 | 3,6 |
| | TM4 | 113,5 | 2,4 | 4,1 |
| | Mesatarja vjetore 2014 | 110,9 | : | 1,6 |
| 2015 | TM1 | 113,7 | 0,2 | 3,6 |
| | TM2 | 114,1 | 0,4 | 4,2 |
| | TM3 | 113,8 | -0,3 | 2,7 |
| | TM4 | 113,8 | 0,0 | 0,3 |
| | Mesatarja vjetore 2015 | 113,9 | : | 2,7 |
| 2016 | TM1 | 113,2 | -0,5 | -0,4 |
| | TM2 | 114,4 | 1,1 | 0,3 |
| | TM3 | 113,8 | -0,5 | 0,0 |
| | TM4 | 113,7 | -0,1 | -0,1 |
| | Mesatarja vjetore 2016 | 113,8 | : | -0,1 |
| 2017 | TM1 | 114,2 | 0,4 | 0,9 |
| | TM2 | 113,8 | -0,4 | -0,5 |
| | TM3 | 114,3 | 0,4 | 0,4 |
| | TM4 | 115,5 | 1,0 | 1,6 |
| | Mesatarja vjetore 2017 | 114,5 | : | 0,6 |
| 2018 | TM1 | 114,4 | -1,0 | 0,2 |
| | TM2 | 115,7 | 1,1 | 1,7 |
| | TM3 | 116,9 | 1,0 | 2,3 |
| | TM4 | 117,0 | 0,1 | 1,3 |
| | Mesatarja vjetore 2018 | 116,0 | : | 1,4 |
| 2019 | TM1 | 116,8 | -0,2 | 2,1 |
| | TM2 | 117,0 | 0,2 | 1,1 |
| | TM3 | 117,6 | 0,5 | 0,6 |
| | TM4 | 116,9 | -0,6 | -0,1 |
| | Mesatarja vjetore 2019 | 117,1 | : | 0,9 |

Grafiku1: Zhvillimi i IÇP, Tremujori i parë 2009 –Tremujori i katërt 2019 (2010=100)




Tabela 2: Peshat, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (2010=100) dhe ndryshimet Tremujore dhe vjetore në përqindje

| Kodet | Nomenklatura e veprimtarive ekonomike rev.2 | NVE | Peshat | TM4 - 2019 | TM4 - 2019 | TM4 - 2019 |
|-------|---|-----|----------------|--------------|-------------|-------------|
| | | | | Ø2010=100 | TM3 - 2019 | TM4 - 2018 |
| | Gjithsej IÇP | | 1000,00 | 116,9 | -0,6 | -0,1 |
| 05 | Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve | | 3,73 | 137,5 | 0,0 | 0,0 |
| 07 | Nxjerrja e xehes së metalit | | 11,76 | 177,1 | -5,9 | -19,6 |
| 08 | Xeherorët dhe guroret tjera | | 21,53 | 131,1 | 0,0 | 0,0 |
| 10 | Përpunimi i produkteve ushqimore | | 135,16 | 110,6 | -0,5 | 0,8 |
| 11 | Prodhimi i pijeve | | 59,69 | 104,4 | 0,0 | -0,1 |
| 13 | Prodhimi i tekstilit | | 11,32 | 0,0 | 0,0 | 0,0 |
| 14 | Prodhimi i veshjeve | | 4,20 | 0,0 | 0,0 | 0,0 |
| 15 | Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës | | 6,91 | 101,7 | -0,1 | -2,1 |
| 16 | Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara - thurëse | | 22,62 | 102,3 | 2,2 | 1,1 |
| 17 | Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës | | 10,68 | 81,3 | 1,0 | 0,6 |
| 18 | Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara | | 7,95 | 0,0 | 0,0 | 0,0 |
| 20 | Prodhimi i produkteve kimike | | 19,05 | 132,7 | -0,7 | -3,1 |
| 21 | Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutike | | 2,21 | 0,0 | 0,0 | 0,0 |
| 22 | Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës | | 71,77 | 100,4 | -0,6 | 0,8 |
| 23 | Prodhimi i produkteve minerale jometalike | | 140,57 | 101,2 | -0,7 | 2,7 |
| 24 | Prodhimi i metaleve | | 50,80 | 82,5 | -1,4 | -0,1 |
| 25 | Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve | | 63,01 | 88,4 | -0,6 | 0,2 |
| 27 | Prodhimi i pajisjeve elektrike | | 6,77 | 105,7 | 1,0 | 1,3 |
| 28 | Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t | | 2,75 | 91,3 | 0,0 | 0,0 |
| 30 | Prodhimi i mjeteve motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove | | 1,36 | 122,2 | 8,1 | 3,5 |
| 31 | Prodhimi i mobilie | | 26,68 | 100,8 | 0,2 | 3,9 |
| 32 | Prodhimi tjetër p.k.t. | | 1,05 | 0,0 | 0,0 | 0,0 |
| 35 | Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajr të kondicionuar | | 292,01 | 134,5 | -0,8 | -1,5 |
| 36 | Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë | | 18,08 | 104,1 | 0,0 | -1,2 |
| 38 | Veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve | | 8,33 | 0,0 | 0,0 | 0,0 |

Definicioni dhe qëllimi i IÇP

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) është tregues relativ që mat shkallën në të cilën çmimet e mallrave (prodhimeve) të prodhuara dhe shërbimeve ndryshojnë në periudha të caktuara kohore. Kryesisht si parametër statistikor ka një rëndësi të veçantë si deflator i Bruto Prodhimit Vendor me qasjen e prodhimit.

Metodologjia

Çmimet dhe vlera e prodhimeve industriale janë grumbulluar nga ndërmarrjet prodhuese më reprezentative në Kosovë. Vlera e prodhimit dhe çmimi mesatar vjetor janë TM_1 për vitin 2007, ndërsa nga TM_1 për vitin 2009 bëhet grumbullimi i rregullt në kontinuitet për çdo tremujor.

Për shkak të krahasueshmërisë së të dhënave me të dhënat e Eurostatit, me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës që nga 01/09/2014 ka filluar të përdorë nomenklaturën e re të aktiviteteve ekonomike (NACE Rev.2) bazuar në “Rregulloren Nr.11/2013 për implementimin e standartit për klasifikimin e veprimtarive” kështu që edhe Indeksi i çmimeve të prodhimit ka pësuar ndryshime në përputhje me këtë nomenklaturë.

Njëherit edhe Indeksi bazë ka pësuar ndryshime duke kaluar nga viti bazë 2007=100 në vitin bazë 2010=100. Në llogaritjen e këtij indeksi nuk merrin pjesë Ndarjet 13, 14, 18, 21, 32 dhe 38 marrin pjesë në llogaritjen e Indeksit, por për shkak se çmimet për keto Ndarje kanë filluar të grumbullohen pas vitit 2010 dhe u mungon indeksi bazë 2010=100 e që me vonë do t'u krijohet indeksi bazë dhe do të llogariten edhe këta indikatorë.

Që nga viti 2019, IÇP është i llogaritur për 25 Ndarje (aktivitete ekonomike), 195 ndërmarrje prodhuese mbi 800 (konkretisht 807) artikuj. Si projekt (GOPA - ASK) ka filluar gjatë vitit 2007 me qëllim që të krijohet baza elementare për themelimin e hulumtimit të IÇP-se, ndërsa nga mesi i vitit 2010 projekti është duke u mbështetur nga SIDA suedeze.

IÇP nga tremujori i parë 2019 përdorë peshat specifike të rifreskuara nga të dhënat e Anketës Strukturore të Bizneseve (ASN), viti 2017.

Për llogaritjen e IÇP-se është përdorë formula e Lasperit

Agregimi deri në IÇP në tërësi

$$PPI_0^q = 100 * \sum_{g=1}^h w_g * I_{0,g}^q$$

PPI_0^q = Indeksi i çmimeve të prodhimit në mes tremujorit 0 dhe tremujorit q

w_g = Pesha për grupe

$I_{0,g}^m$ = Shkalla e çmimit për grupin g mes tremujorit 0 dhe tremujorit q

h = Numri i aktiviteteve ekonomike sipas NACE Rev2.

Llogaritja e indeksit zingjiror të IÇP

$$PPI_{2010}^{Y,q} = \frac{PPI_{2010}^{Y-1,4}}{100} * PPI_0^{Y,q}$$

$PPI_{2010}^{Y,q}$ = Indeksi zingjiror i IÇP mes 2010 dhe tremujorit q në vitin aktual

$PPI_{2010}^{Y-1,4}$ = Indeksi zingjiror i IÇP mes 2010 dhe tremujorit të katërt në vitin paraprak

$PPI_0^{Y,q}$ = Indeksi i Çmimit të prodhimit mes tremujorit 0 dhe tremujorit q në vitin aktual

Llogaritja e ndryshimeve

Ndryshimi në mes tremujorit q dhe tremujorit q-1 është kalkuluar si vijon:

$$\left[\left(\frac{PPI_0^{Y,q}}{PPI_0^{Y,q-1}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Përqindja e ndryshimit tremujor}$$

$PPI_0^{Y,q}$ = Indeksi i çmimeve të prodhimit për tremujorin aktual q

$PPI_0^{Y,q-1}$ = Indeksi i çmimeve të prodhimit për tremujorin paraprak q-1

Ndryshimi vjetor kalkulohet si :

$$\left[\left(\frac{PPI_{2010}^{Y,q}}{PPI_{2010}^{Y-1,q}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Përqindja e ndryshimit vjetor}$$

$PPI_{2010}^{Y,q}$ = Indeksi i çmimeve të prodhimit industrial për tremujorin aktual q

$PPI_{2010}^{Y-1,q}$ = Indeksi i çmimeve të prodhimit industrial për vitin dhe tremujorin paraprak q

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: Departamentet prodhuese; Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale; Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 159 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 75,5% me shkollim universitar, 12,3 me shkollim të lartë, ndërsa 12,3% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruet terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informatat të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-qov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-qov.net>